



## Asociacioni i Komunave të Kosovës

---

### RAPORT

|                  |   |
|------------------|---|
| <b>Për:</b>      | <b>Ertan Munoglu – Menaxher i Programit</b>                                 |
| <b>Nga:</b>      | <b>Fisnik Dashi – Koordinator për Kolegjiume</b>                            |
| <b>Kopje:</b>    | <b>Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv</b>                                 |
| <b>Data :</b>    | <b>18 maj 2011</b>  |
| <b>Subjekti:</b> | <b>Raport nga takimi i Kryesisë së Kolegjiumit për Ekonomi dhe Zhvillim</b> |

#### HYRJE

Kryesia e Kolegjiumit për Ekonomi dhe Zhvillim me datën 12 maj mbajti mbledhjen e rregullt të saj dhe të parën për vitin 2011.

Në këtë takim ishin prezentë z. Shpwrtim Reznici – Kryesues, z. Nasuf Aliu – Zv.kryesues, anëtarët z. Sabedin Vllasaliu (i cili u largua menjherë për shkak të obligimeve), dhe i deleguari nga Komuna e PRishtinës z. Isak Mehmeti. Në takim poashtu ishin prezent edhe z. Ertan Munoglu – Menaxher i Programit në AKK, dhe z. Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve në AKK.

Takimi kishte për qëllim fillimin e hartimit të Planit Vjetor të Punës për vitin 2011 të Kolegjiumit për Ekonomi dhe Zhvillim dhe të përcaktoj listën e prioriteteve, objektivave, dhe aktiviteteve të Kolegjiumit, si dhe mënyrën e lobimit për përmbushjen e prioriteteve të Kolegjiumit.

## **PËRMBLEDHJE:**

Mbledhjen e hapi z. Shpëtim Reznici me diskutimin e pikave të rendit të ditës:

- Përpilimi i planit të punës së kolegjiut
- Identifikimi i nevojave për trajnim
- Vizita nëpër Komunitat e Kosovës për shkëmbim të përvojave
- Definimi i takimit të radhës së Kolegjiut
- Çështje tjera

Pas diskutimeve dhe debatit, Kryesia vendosi për këto prioritete dhe objektiva në realizimin e planit të punës së Kolegjiut për Ekonomi dhe Zhvillim në vitin 2011.

- **Krijimi i kushteve më të mira për bizneset** duke pasur për objektive lehtësimin e procedurave komunale për bizneset, kompletimin e infrastrukturës ligjore, si dhe Zhvillimin e Zonave ekonomike.
- **Menaxhimi i pyjeve** duke pasur për objektive decentralizimin e kompetencave në fushën e pylltarisë.

### **Takimi i radhës**

Takimi kishte për objektive edhe përcaktimin e pikave të rendit të ditës për takimin e radhës së Kolegjiut për Ekonomi dhe Zhvillim. Kryesia për fund vendosi që takimi i Kolegjiut të mbahet të martën me datën 06.06.2011 në Gjakovë.

Agjenda e takimit është përcaktuar si vijon:

1. Themelimi i one-stop shopeve në të gjitha komunitat
2. Përshpejtimi i bartjes së kompetencave për regjistrimin e bizneseve në të gjitha komunitat
3. Identifikimi i pjesëmarrësve potencial në Grupet punuese në procesin legjislativ

Anëtarët ranë dakord që stafi i AKK-së të jetë përgjegjës për përgatitjen e ftesave, dhe sigurimit të ambientit ku do të mbahet mbledhja.